

VENDIM
Nr. 7, datë 10.1.2018

MBI MIRATIMIN E LICENCËS “TIP”
TË AKTIVITETIT TË SHPËRNDARJES
SË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 22; 23 dhe 50 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për miratimin e licencës “tip” për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s;

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 161, datë 12.10.2017, ERE ka filluar procedurat për miratimin e licencës së shpërndarjes së gazit natyror.

- Me shkresën nr. 100/52 prot., datë 17.10.2017, ERE ka vijuar me publikimin me media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e licencës së shpërndarjes së gazit natyror.

- Me shkresën nr. 684 prot., datë 20.10.2017, ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga MIE, MFE, Autoriteti i Konkurrencës, Albgaz sh.a. dhe Albpetrol sh.a. Drafti është përcjellë për komente edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë draftlicencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Albgaz sh.a., komentet e të cilëve janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë licencën “tip” për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCË
PËR
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR

Licencë nr.: _____

Vendimi i ERE-s nr. _____, i datës: _____ Data efektive: _____

Lëshuar personit: _____
(Emri i plotë dhe adresa ligjore e personit)

NUIS: _____

Vendimi i ERE-s për certifikimin e subjektit _____

Sipas Autoritetit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe në përputhje me:

Ligjin “Për sektorin e gazit natyror” nr. 102/2015;

Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror, miratuar nga ERE me vendimin e bordit nr. 97, datë 4.7.2016;

Rregulloren mbi procedurat e heqjes së licencave në sektorët e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017;

Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar nga ERE me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, dhe

Rregullat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me sektorin e gazit natyror.

Enti Rregullator i Energjisë i jep këtë licencë shpërndarjeje (Licencë) për kryerjen e aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror në zonën e përcaktuar në këtë licencë, personit të sipërpërmendur, këtej e tutje referuar si “I licencuari”, subjekt i kushteve të licencës bashkë-ngjitur dhe pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj licence.

Kjo licencë së bashku me kushtet e saj bashkëngjitur janë të vlefshme prej datës efektive të sipërshënuar dhe do të ketë efekt për një periudhë 30-vjeçare, në qoftë se licenca nuk përfundon nga ERE, neni 27 i ligjit 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe në përputhje me Rregulloren mbi procedurat për heqjen e licencave në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror dhe kushtet që përmban kjo licencë.

Autoriteti lëshues (ERE)

Kryetari

[selia e ERE-s]

Pranuar prej personit të licencuar së bashku me kushtet e licencës;

I licencuari

Përfaqësuesi zyrtar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

KUSHTET E LICENCËS
PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR

Licencë nr: _____

Vendimi i ERE-s nr. _____, i datës: _____ Data efektive: _____

Licencë lëshuar personit: _____

(Emri i plotë dhe adresa ligjore e personit)

NUIS _____

PJESA E PARË

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

a) Në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE është i vetmi autoritet në Republikën e Shqipërisë që ka të drejtën të lëshojë dhe deklarojë vlefshmërinë e kësaj licence.

b) Nëse bazuar në një vendim me shkrim të ERE-s, ndonjë ose disa prej kushteve të kësaj licence bëhen të pavlefshme, anulohen apo pushojnë së qeni në fuqi, kushti ose kushtet në fjalë duhet të hiqen nga kushtet e licencës, ndërkohë që kushtet e tjera të licencës mbeten efektive dhe me fuqi të plotë.

c) Nuk lejohet transferim i të drejtave të licencës apo të aseteve tek asnjë person tjetër, pa aprovimin paraprak me shkrim të ERE-s. Kur aprovon një transferim, ERE mund të modifikojë periudhën e licencimit dhe ndonjë kusht tjetër të licencës, duke treguar arsyen.

d) I licencuari duhet të respektojë ligjet në fuqi, vendimet e qeverisë, rregullat dhe rregulloret, si edhe vendimet e aprovuara nga ERE.

e) ERE ka të drejtën ekskluzive për modifikimin e kësaj licence në rastin e ndryshimit të kushteve dhe rrethanave në përputhje me ndryshimet në ligj, vendimet e qeverisë, rregullat dhe rregulloret, si edhe vendimet e aprovuara nga ERE.

Termat dhe përkufizimet e përdorura mbi:

Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”; Rregulloren mbi procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror; rregullat dhe rregulloret që i përkasin sektorit të gazit natyror, përfshihen në këtë licencë për çdo qëllim. Fjalë dhe fraza të tjera, të përdorura në këtë licencë dhe në kushtet e licencës, të cilat nuk përfshihen në ligjet dhe rregulloret e mësipërme, kanë kuptimet si më poshtë vijon:

“Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

“Ndërsubvencionime” do të thotë transferimi i fondeve ose ndarje e kostove ndër llogaritë e të licencuarit ose llogaritë e bizneseve shoqëruese, me qëllim mbështetjen financiare të një aktiviteti apo biznesi tjetër, përveç shpërndarjes së gazit natyror nga të ardhurat e fituara nga i licencuari që kryen aktivitetin e licencuar ose duke i kaluar kostot e shkaktuara nga i licencuari që kryen aktivitetin e licencuar tek një aktivitet apo biznes tjetër përveç atij të shpërndarjes së gazit natyror.

“Aktivitet i licencuar” do të thotë aktivitetet e lidhura direkt dhe të nevojshme për operimin dhe përdorimin e sistemit të shpërndarjes dhe ndërveprimin me sistemet e tjera të depozitimit dhe

shpërndarjes, për të kryer aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror në zonën e licencës në përputhje me rregullat dhe rregulloret në fuqi.

I licencuar, sikurse është përdorur në këtë dokument, do të thotë personi i përmendur në faqen e parë të kësaj licence, i cili zotëron lejen dhe autorizohet nga ERE për kryerjen e aktivitetit të licencuar.

“Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes” do të thotë tërësia e rregullave teknike, nëpërmjet të cilave rregullohet funksionimi i rrjetit të shpërndarjes, si dhe vendosen kushtet e shërbimit që ofrohet nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për përdoruesit e këtij sistemi.

“Tarifë e shërbimit të shpërndarjes” ose “tarifë e shpërndarjes” do të thotë çmimi i shërbimit të ofruar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së gazit natyror, i vendosur nga ERE në bazë të metodologjisë së llogaritjes së tarifave miratuar nga ERE sipas neneve 16(1)(a), 32 dhe 33 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

“Përdorues i sistemit të shpërndarjes” (përdorues i sistemit) është personi që furnizon ose furnizohet nga sistemi, si edhe vetë një operator i sistemit, i cili është i lidhur në sistemin e shpërndarjes dhe që përfiton nga shërbimet e shpërndarjes.

“Procedurat e licencimit për sektorin e gazit natyror” do të thotë “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

Legjislacioni në fuqi do të thotë të gjitha standardet, kodet, rregullat, rregulloret, metodologjitë dhe çdo vendim ose akt tjetër në fuqi, të miratuara nga ERE dhe autoritete të tjera kompetente sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Rrjet i Shpërndarjes do të thotë rrjeti i ndërlidhur i tubacioneve të shfrytëzuara për shpërndarjen e gazit natyror në zonën e licencës.

Territori i licencës do të ketë kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të kësaj licence.

Informacion me ndjeshmëri tregtare do të thotë të dhëna në lidhje me biznesin ose me natyrë tregtare të përdoruesve të sistemit, që zotërohen nga i licencuari gjatë procesit të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, të cilat duhet të mbahen konfidenciale.

Informacion me avantazh tregtar do të thotë informacion i lidhur me aktivitetin e vetë të licencuarit, i cili duhet të mbahet konfidencial dhe nuk duhet t’i jepet apo t’i bëhet i ditur të tjerëve në mënyrë diskriminuese.

Neni 2

Territori i ushtrimit të aktivitetit të licencuar

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zhvillimin e sektorit të gazit natyror në Shqipëri, i licencuari do të ushtrojë aktivitetin e licencuar për shpërndarjen e gazit natyror në zonën e licencës.

2. Zona e licencës do të përfshijë njësitë administrative që vijojnë:

3. Përfshirja e të gjithë rrjetit të shpërndarjes në rrjetet përkatëse administrative, përfshirë shpërndarjen e gazit natyror, tubacionin ose tubacionet lidhëse të sistemit të shpërndarjes me pikën ose pikat e daljes prej sistemit të transmetimit, prej të cilit ose të cilave do të sigurohet lëvrimi i gazit natyror.

4. Çdo ndryshim i zonës së licencës kryhet në përputhje me procedurat e licencimit për sektorin e gazit natyror apo rregullat dhe rregulloret të tjera që miratohen ose ndryshohen nga ERE.

PJESA E DYTË

Neni 3

Detyrimet operacionale të të licencuarit

1. I licencuari autorizohet që sipas kësaj licence të kryejë aktivitetin e licencuar në zonën e licencës. Mbështetur në nenin 23(3) të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe legjislacionit në fuqi, kjo e drejtë i jepet të licencuarit mbi baza ekskluzive.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes dhe rregullore të tjera në fuqi, me kusht që sistemi i shpërndarjes të ketë kapacitet të mjaftueshëm dhe të plotësojë të gjitha kushtet e tjera teknike e tregtare.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron akses jodiskriminues të të gjithë përdoruesve të sistemit në rrjetin e shpërndarjes, siç kërkohet në kushtet e licencës dhe në përputhje me nenin 54 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Kodit të Rrjetit të Shpërndarjes dhe legjislacionit në fuqi, duke shmangur diskriminimin ndërmjet përdoruesve të sistemit ose kategorive të përdoruesve, sidomos në favor të shoqërive të lidhura me të.

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes u siguron përdoruesve të sistemit informacion lehtësisht të aksesueshëm nga palët për shërbimet e ofruara, kushtet e shërbimit, si dhe një informacion të nevojshëm teknik për një akses efektiv në rrjet, në përputhje me përjashtimet nga informacioni konfidencial, të miratuar nga ERE.

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i siguron çdo operatori të sistemit informacionin e mjaftueshëm për të siguruar transportimin e depozitimin e gazit natyror dhe bërjen të mundur në përputhje me operimin e sigurt dhe efikas të sistemit të interkoneksionit.

6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes publikon kushtet dhe kriteret e miratuara nga ERE, përfshirë rregullat dhe tarifat për sigurimin e shërbimeve të shpërndarjes, si dhe të dhënat lidhur me tregun e shpërndarjes.

7. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për balancimin e sistemit të shpërndarjes, rregullat e miratuara prej tij për këtë qëllim do të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, përfshirë këtu edhe rregullat për faturimin e përdoruesve për disbalancimin. Detyrimet dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifat për sigurimin e shërbimeve të tilla nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, përcaktohen në bazë të një metodologjie të miratuar nga ERE në mënyrë jodiskriminuese dhe me kosto efektive, e cila publikohet.

8. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ruan konfidencialitetin e çdo informacioni të ndjeshëm tregtar në lidhje me përdoruesit, të marra këto gjatë veprimtarisë së tij, dhe parandalon përhapjen e informacionit me avantazh tregtar në mënyrë diskriminuese, që mund të krijojnë avantazhe tregtare në momentin që bëhen publike. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në shitjen ose blerjet e gazit natyror nga shoqëritë përgjegjëse, nuk duhet të abuzojë me informacionin tregtar të marrë nga palët e treta në dhënien apo negocimin e aksesit në sistem.

9. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për kryerjen e kontrollit teknik në objektet ku OSSH-ja bën shpërndarjen e gazit natyror, në mënyrë që të garantojë se ato operojnë në përputhje me rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror.

10. I Licencuari është përgjegjës për të siguruar jetëgjatësinë e sistemit të shpërndarjes brenda territorit të licencës dhe do të operojë, mirëmbajë, përdorë dhe zhvillojë sistemin e shpërndarjes në mënyrë të sigurt, të besueshëm dhe eficient, duke pasur parasysh mjedisin dhe eficiencën e energjisë, dhe të sigurojë kapacitet të mjaftueshëm për të plotësuar kërkesat e të gjithë përdoruesve të sistemit.

11. I Licencuari duhet të sigurojë një performancë të sigurt dhe eficiente të aktivitetit të Licencuar

brenda territorit të licencës sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Kodit të Rrjetit të Shpërndarjes, legjislacionit në fuqi, dhe kushteve të kësaj licence.

12. I licencuari duhet të jetë i pavarur, i ndarë nga çdo aktivitet tjetër që nuk ka lidhje me aktivitetin e licencuar, sipas nenit 51 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Kjo nuk duhet të ndikojë tek operimi i të licencuarit si operator i kombinuar sipas nenit 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

13. Jo më vonë se 6 muaj nga data efektive e kësaj licence, i licencuari do të përgatisë dhe dorëzojë për miratim prej ERE-s një propozim të Kodit të Sistemit të Shpërndarjes, sipas nenit 55 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

14. I licencuari do të sigurojë që sistemi i shpërndarjes dhe gjithë tubacionet, impiantet dhe pajisjet përbërëse përfshirë kompresorët, reduktorët e presionit, matësit dhe çdo pajisje tjetër janë ndërtuar dhe mirëmbahen sipas rregullave teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror. Ndërtimi dhe përdorimi i tubacioneve të shpërndarjes së gazit natyror dhe infrastruktura të tjera të sistemit të shpërndarjes duhet t’u nënshtrohen autorizimeve që kërkohen sipas nenit 11 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

15. I licencuari duhet të përgatisë dhe paraqesë në ERE planin e zhvillimit dhe investimeve të rrjetit të shpërndarjes për 10 vjet, për garantimin e sigurisë, besueshmërinë, rregullsisë dhe cilësisë së aktivitetit të licencuar sipas nenit 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Plani do të përshtatet çdo vit për 10 vitet e ardhshme dhe të paraqitet në ERE. Plani i zhvillimit dhe i investimeve do të përmbajë tregues afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Treguesit afatshkurtër do të mbulojnë një periudhë prej 3 vjetësh, ata afatmesëm për një periudhë prej 6 vjetësh dhe ata afatgjatë një periudhë prej 10 vjetësh.

16. Plani i zhvillimit të investimeve të rrjetit të shpërndarjes bëhet detyrues sipas të licencuarit pasi të jetë konsultuar dhe miratuar nga ERE dhe zbatuar nga i licencuari. Zbatimi i planit monitorohet nga ERE sipas afateve dhe kushteve të vendosura të ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

17. Plani për zhvillimin dhe zgjerimin e sistemit të shpërndarjes, Operatorit i Sistemit të Shpërndarjes merr në konsideratë dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe të eficiencës së energjisë. Ky plan në veçanti do të përmbajë:

- a) Një përshkrim të situatës aktuale të sistemit të shpërndarjes;
- b) Një përshkrim dhe vlerësim të rasteve të refuzimit të aksesit të palëve të treta dhe masat e propozuara për përmirësimin e situatës;
- c) Parashikimin e nevojave për mirëmbajtjen, zhvillimin, zgjerimin dhe modernizmin e sistemit të shpërndarjes dhe aftësitë e tij funksionale për plotësimin e nevojave për kapacitete shpërndarëse të të gjithë përdoruesve të zonës së licencës për periudhën përkatëse;
- d) Ndërveprimi me sistemin e transmetimit me të cilin është lidhur;
- e) Burimet financiare për zbatimin e planit.

18. I licencuari nuk do të pengojë ose tentojë të pengojë pjesëmarrës të tjerë të tregut apo konkurrentë të ndryshëm që synojnë të angazhohen në një biznes të gazit natyror në Republikën e Shqipërisë.

19. I licencuari nuk do të vendosë asnjë pagesë tjetër për shërbimet e shpërndarjes përveç tarifës së shpërndarjes të miratuar nga ERE.

20. I licencuari nuk do të angazhohet në ndërsuvencionime. Në përputhje me nenin 30, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe rregullat dhe rregulloret e ERE-s, i licencuari mban llogari të ndara për secilën nga veprimtaritë e licencuara që ushtron, si dhe llogari të ndara për aktivitetet që mund të jenë të konsoliduara në mënyrë të tillë që të provojë në mënyrë të besueshme pranë ERE-s dhe çdo autoriteti tjetër kompetent se nuk ka ndërsuvencionime, nuk cenohet konkurrenca dhe nuk ka diskriminim në aktivitete të të licencuarit. I licencuari duhet të hartojë, paraqesë për auditim dhe publikojë bilancet e tyre vjetore sipas kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në ligjet në fuqi dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

21. I licencuari nuk do të angazhohet në asnjë formë monopoli ose aktivitete të tjera që dëmtojnë

konkurrencën. Kjo nuk duhet të ndikojë te autorizimi ekskluziv dhënë për të licencuarin për kryerjen e aktivitetit të licencuar në territorin e licencuar sipas nenit 23 (3) të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe pikës 2 të kushteve të kësaj licence.

22. Gjatë kryerjes së aktivitetit të licencuar, i licencuari është përgjegjës për sigurinë e shëndetit dhe jetës së njerëzve, të pronës së tyre, si dhe për dëmtimin e ambientit në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror dhe rregullat dhe rregulloret e miratuara nga ERE. I licencuari duhet të disponojë një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri), që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave ose për humbjen, ose shkatërrimin e pronës, të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD. Kjo politikë ose këto politika sigurie do të jenë dhe qëndrojnë në fuqi dhe me efekt të plotë për të gjithë kohëzgjatjen e licencës së kërkuar. Për më tepër, i licencuari do të mbetet përgjegjës për çdo dëmtim që do të mund të ndodhë prej ose të lidhet me, ose të rezultojë prej aktiviteteve të kryera gjatë kohëzgjatjes së licencës.

23. Në çdo kohë, i licencuari duhet të disponojë dhe të vendosë në dispozicion të ERE-s të dhëna të sakta mbi:

- a) vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë hartën topografike;
- b) zonën gjeografike të mbuluar;
- c) kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (*in take*) në sistem dhe të daljes (*off take*) prej sistemit dhe ndërlidhjet e tij me rrjetet e tjera të transmetimit dhe shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimit dhe terminalët e GNL-së;
- d) volumet e projektuara ditore për t’u përpunuar sipas vlerësimeve të tij;
- e) standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen;
- f) presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e tij;
- g) kategoritë e konsumatorëve dhe livrimet e projektuara;
- h) vendndodhjet e matësve dhe specifikimet;
- i) planet e aromatizimit përfshirë vendndodhjet;
- j) dëshmi të kontratave/angazhimeve.
- k) programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit;
- l) sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t’u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

24. Në qoftë se i licencuari përballet ose parashikon një situatë emergjence që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve, ose sigurinë e pronës së tyre, ambientin, qëndrueshmërinë e sistemit të shpërndarjes ose sigurinë e furnizimit, atëherë i licencuari ndërmerr hapat e nevojshme për të përmirësuar ose parandaluar ndikimet e situatës emergjente aktuale ose të pritshme, sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Plani i Emergjencave, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes, rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror dhe/ose rregulla dhe rregullore të tjera që aplikohen. Pa vonesë, në vijim i licencuari duhet të njoftojë ERE-n dhe çdo autoritet tjetër të nevojshëm për situatën emergjente dhe veprimet ose planet e të licencuarit për menaxhimin e kësaj situatë.

25. I licencuari nuk do të angazhohet i vetëm ose së bashku me persona të tjerë në aktivitete të cilat kanë për qëllim ose mund të dëmtojnë natyrën e drejtë, të hapur dhe jodiskriminuese të sistemit të shpërndarjes dhe tregut të gazit natyror. I licencuari mund të bashkëpunojë me persona të tjerë në aspekte të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe përmirësimit të sistemit të shpërndarjes pa ndikuar te pavarësia e detyruar dhe ndarja sipas nenit 51 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe përgjegjësinë ekskluzive për të kryer aktivitetin e licencuar sipas termave dhe kushteve të vendosura te ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, legjislacioni në fuqi dhe kushteve të kësaj licence.

26. Në rastet kur operatori i sistemit të shpërndarjes është pjesë e një kompanie vertikalisht të integruar, ai duhet të jetë i pavarur nga forma e organizimit ligjor dhe e vendimmarrjes, nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me shpërndarjen, pa detyrimin për të ndarë pronësinë e asetëve të sistemit të shpërndarjes nga kompanitë vertikalisht të integruara. Kur operatori i sistemit të shpërndarjes është pjesë e një kompanie vertikalisht të integruar, ai duhet të jetë i pavarur në aspektin organizativ dhe të vendimmarrjes nga aktivitetet e tjera që nuk lidhen me shpërndarjen.

27. I licencuari kryen aktivitetin e licencuar, zhvillon politika dhe programe, si edhe merr masat e nevojshme për përmirësimin dhe nxitjen e eficiencës ekonomike dhe operacionale të sistemit të shpërndarjes dhe siguron që furnizimi me gaz natyror të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe kërkesat, praktikat dhe standardet europiane lidhur me cilësinë e shërbimit dhe qëndrueshmërinë e sistemit të shpërndarjes.

28. I licencuari nuk angazhohet në aktivitete, qoftë ato direkte ose përmes kompanive që kanë lidhje, të cilat pengojnë kryerjen e aktivitetit të licencuar. I licencuari duhet të njoftojë ERE-n në rast se ai planifikon të:

- a) angazhohet në aktivitete të tjera, përveç aktivitetit të licencuar; ose
- b) të ngrejë një biznes shoqërues.

29. ERE mund të ndalojë ose të vendosë kushte të veçanta për angazhimin e të licencuarit në aktivitete përveç aktivitetit të licencuar dhe për ngritjen e bizneseve shoqëruese, me qëllim mbrojtjen e përdoruesve të sistemit dhe për t'u siguruar që nuk ka ndërsubvencionime të aktiviteteve.

30. I licencuari nuk është përgjegjës për mosplotësimin e kushteve të licencës në rastin e forcës madhore, në masën që, dhe për periudhën në të cilën forca madhore nuk lejon plotësimin e kushteve të licencës. Në rastin e forcës madhore, i licencuari duhet të njoftojë menjëherë ERE-n dhe përdoruesit e tjerë të rrjetit me të cilët ka lidhur kontratë. I licencuari duhet të rivendosë ofrimin e shërbimeve të ndërprera sipas termave dhe kushteve të përcaktuara të Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes, legjislacionit në fuqi dhe kontratës së shpërndarjes.

31. I licencuari duhet të planifikojë dhe të marrë masa për sigurimin e furnizimit me gaz natyror sipas standardeve të krijuara të Plani i Emergjencave sipas nenit 6, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror" dhe do të jetë përgjegjës për sigurimin e furnizimit me gaz natyror sipas kompetencave të tij ndërsa kryen aktivitetin e licencuar.

32. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një shoqërie të integruar vertikalisht, ai është i pavarur, në aspektin e organizimit të tij dhe në marrjen e vendimeve, nga veprimtaritë e tjera që nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen.

33. Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një shoqërie të integruar, me qëllim që të jetë i pavarur, në aspektin organizativ dhe të vendimmarrjes, nga aktivitetet e tjera që nuk lidhen me shpërndarjen e gazit natyror, ai duhet të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton programin e përputhshmërisë, ku parashikohen masat për të siguruar se sjellja diskriminuese është e përjashtuar dhe për të siguruar se respektimi i saj monitorohet në mënyrën e duhur.

Neni 4

Kontrolli i centralizuar dhe koordinimi i sistemit të shpërndarjes

1. I licencuari duhet të drejtojë dhe koordinojë operimin e sistemit të shpërndarjes në përputhje me Kodin e Sistemit të Shpërndarjes, rregullat dhe rregulloret e miratuara nga ERE.

2. Për sigurimin e koordinimit të aktivitetit të licencuar dhe operimin efektiv e të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes, i licencuari instalon, përdor dhe mirëmban pajisjet e nevojshme për mbrojtjen e sistemit të shpërndarjes nga gabimet operacionale, humbjet e linjës apo çdo ngjarje tjetër të mundshme, e

cila mund të ketë efekt të dëmshëm në sistemin e shpërndarjes ose pajisjet e instalimet e lidhura me të.

Neni 5

Ndryshimet në sistemin e shpërndarjes

1. I licencuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo rrethanë që çon në ndryshime të rëndësishme të kapacitetit shpërndarës të linjave dhe impianteve dhe pajisjeve të sistemit të shpërndarjes, për një periudhë me të gjatë se tridhjetë (30) ditë dhe do t'i paraqesë ERE-s opinionin e tij për zgjidhjen më të përshtatshme të situatës për të reduktuar ndikimin e dëmshëm.

2. I licencuari do të informojë ERE-n për planet për reduktimin e presionit të tubacioneve ose të pajisjeve të sistemit të shpërndarjes të paktën dymbëdhjetë (12) muaj para reduktimit të planifikuar dhe do t'i paraqesë ERE-s një shpjegim të detajuar të veprimeve dhe masave që do të merren për të zvogëluar ndikimin negativ të mundshëm.

3. I licencuari nuk do të lidhë kontrata, për të cilat është ose duhet të jetë në dijeni të pasojave që përbëjnë shkelje të kushteve të licencës.

4. I licencuari mund të pezullojë shërbimet e sistemit të shpërndarjes për një apo më shumë përdorues të sistemit, për një periudhë kohe, kur veprimi apo mosveprimi i një personi rrezikon qëndrueshmërinë, sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të shpërndarjes për përdoruesit e tjerë të sistemit të shpërndarjes, ose mund të pengojë përmbushjen e kushteve të licencës. I licencuari, pa vonesë duhet të njoftojë ERE-n dhe ndonjë person tjetër të prekur nga kjo situatë, lidhur me veprimet e pezulluara sipas këtij paragrafi. Këto njoftime duhet të përmbajnë një opinion të argumentuar në lidhje me natyrën, madhësinë dhe periudhën e zgjatjes së këtyre pezullimeve. I licencuari duhet të rivendosë ofrimin e shërbimeve të ndërprera sipas termave dhe kushteve të përcaktuara të Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes, rregullore dhe rregulla të tjera që aplikohen dhe kontratave të shpërndarjes.

5. I licencuari duhet të vendosë dhe zbatojë programin e pajtueshmërisë duke përcaktuar masat e ndërmarra për të siguruar që përjashtohet sjellja diskriminuese dhe duhet të emërojë zyrtarin e pajtueshmërisë sipas nenit 51 (4) të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

6. I licencuari duhet të kryejë detyrat e tjera të përcaktuara në kuadër të aktivitetit të licencuar nga ligji nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", ligjeve të tjera që aplikohen në Shqipëri, rregulloret dhe rregullat që aplikohen dhe kushteve të kësaj licence.

Neni 6

Detyrimet për raportim të të licencuarit

1. Deri në datën 15 shkurt të çdo viti, i licencuari dërgon në ERE një raport për aktivitetin operacional për vitin paraardhës. ERE mundet të vendosë kushte të veçanta për formën e raportimit.

2. Raporti vjetor do të paraqesë analizën e veprimtarisë operationale të të licencuarit dhe do të trajtojë minimalisht çështjet që vijojnë:

a) Volumin e gazit natyror të shpërndarë gjatë vitit paraardhës (sasia totale e gazit natyror të shpërndarë, numrin e përdoruesve të shërbyer) sipas njësive përbërëse të zonës së licencës dhe në total, si dhe krahasime me vitet pararendëse.

b) Masat e marra gjatë vitit për të cilin raportohet për:

i) mbrojtjen e mjeteve dhe pajisjeve nga ndikimet e jashtme, defektet dhe sigurimin e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për aktivitetin e licencuar;

ii) sigurinë në punë;

iii) mbrojtjen e ambientit dhe shëndetit të njerëzve;

iv) monitorimin e operimit të sistemit të shpërndarjes;

v) plotësimin e kushteve për një aktivitet të qëndrueshëm, të vazhdueshëm dhe me cilësi;

vi) plotësimin e kushteve për eficiencën e përdorimit të energjisë; dhe

- vii) analizën e rasteve të emergjencës dhe masave parandaluese.
- c) Realizimin e planit vjetor për zhvillimin dhe zgjerimin e sistemit të shpërndarjes të miratuar nga ERE për vitin paraardhës.
- d) Zbatimin e programit të riparimeve dhe mirëmbajtjes në vitin raportues.
- e) Inspektimet, supervizimet dhe kontrollet e kryera nga organet kompetente, duke i shoqëruar me fotokopje të raporteve, analizave dhe vendimeve përkatëse.
- f) Një vlerësim të nivelit të realizimit të planit për zhvillimin dhe zgjerimin e sistemit të shpërndarjes për vitin që raportohet.
- g) Një vlerësim paraprak të planit për zhvillimin dhe zgjerimin e sistemit të shpërndarjes që duhet të paraqitet i plotë në përputhje me pikën 4.7 të kushteve të kësaj licence.
- h) Realizimin e detyrimit për të mbajtur të informuar konsumatorët dhe masat e marra për përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
- i) Kërkohen informacione dhe të dhëna të tjera për t'u paraqitur sipas kërkesave të monitorimit dhe raportimit të miratuara nga ERE.

Neni 7

Raportimi financiar

1. I licencuari harton, paraqet për auditim dhe publikon bilancet tij vjetore sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara nga ligjet në fuqi dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. I licencuari mban llogari të veçanta për secilën nga veprimtaritë e licencuara që ushtron, si dhe për çdo veprimtari tjetër që nuk lidhet me sektorin e gazit natyror sipas nenit 30 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror". Këto llogari mund të paraqiten të konsoliduara, përveç rastit kur veprimtaritë e kryera lidhen me shpërndarjen apo transmetimin e gazit natyror. I licencuari mban llogari të veçanta financiare për veprimtari të tjera të gazit, të cilat mund të jenë të konsoliduara, duke mbajtur të ndara edhe llogaritë që nuk lidhen me veprimtaritë e parashikuara në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror". Deri në datën 30 qershor të çdo viti, i licencuari dorëzon në ERE pasqyrat financiare të audituara nga ekspertë kontabël të autorizuar, të shoqëruara me:

- Bilancin;
- Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Pasqyra e ndryshimeve në kapital;
- Pasqyra e fluksit të parasë;
- Shënimet shpjeguese.

2. I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe tipave të tjerë të aktiviteteve (përfshirë aktivitetet e autorizuar nga leje të tjera apo koncesione) në bazë të arsyeshme në përputhje me rregullat dhe rregulloret e ERE-s dhe praktikat e biznesit. Në përputhje me kërkesat e pikës 4.10 të kësaj licence dhe me kërkesë të ERE-s, i licencuari dorëzon në ERE pasqyrat financiare të audituara, të cilat mbulojnë të gjitha aktivitetet e të licencuarit. Me kërkesë të ERE-s, i licencuari dorëzon në ERE edhe shpjegimet që justifikojnë bazat për alokimin e shpenzimeve të përgjithshme të kryera nga i licencuari.

Neni 8

Njoftimet

1. I licencuari duhet të njoftojë ERE-n brenda 10 (dhjetë) ditëve për çdo ndryshim në:

- a) Adresën zyrtare;
- b) Statutin e të licencuarit;
- c) Certifikatën e regjistrimit;
- d) Kodin fiskal;

- e) Përfaqësuesit zyrtarë apo organet e tjera drejtuese;
- f) Ndryshimin e strukturës së aseteve nga 10% ose më tepër;
- g) Çdo ndryshim tjetër në organizimin dhe operimin e të licencuarit, të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në aktivitetin e të licencuarit.

2. Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, pretendimet ose korrespondenca tjetër me ERE-n lidhur me licencën duhet të jetë me shkrim dhe të nënshkruara respektivisht nga një zyrtar i autorizuar ose përfaqësues i caktuar i të licencuarit dhe ERE-s, sipas rastit dhe të dërgohet me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit.

PJESA E TRETË

Neni 9

Akresi i palëve të treta në sistemin e shpërndarjes dhe përjashtimi prej kësaj të drejte

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron akses në sistemin e shpërndarjes, brenda kufijve të kapaciteteve të shpërndarjes dhe rregullave teknike, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, të miratuar nga ERE.

2. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes u ofron të njëjtin shërbim klientëve të ndryshëm, atëherë ky shërbim ofrohet sipas kriterëve të njëjta dhe kushteve kontraktuese, qoftë duke përdorur kontratat e harmonizuara dhe/ose në pajtim me Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes publikon kushtet dhe kriteret e miratuara nga ERE, përfshirë rregullat, garancitë dhe tarifat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e shpërndarjes. Këto kushte dhe rregulla zbatohen në mënyrë objektive për të gjithë klientët dhe pa diskriminim ndërmjet përdoruesve të rrjetit.

4. Shërbimet e aksesit të palës së tretë jepen përkundrejt garancive nga përdoruesit e rrjetit për aftësinë financiare. Të tilla garanci nuk duhet të përbëjnë pengesa të panevojshme për hyrjen në treg dhe duhet të jenë jodiskriminuese, transparente dhe proporcionale.

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojë aksesin në sistemin e shpërndarjes, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji.

Neni 10

Braktisja dhe rehabilitimi

1. Në përputhje me rregullat dhe rregulloret në fuqi, i licencuari braktis pajisjet dhe impiantet dhe rehabiliton vendndodhjen e pajisjeve dhe mjedisin përreth në rastet kur:

a) pajisjet dhe impiantet janë jashtë shërbimi, të dëmtuara dhe nuk janë riparuar gjatë një periudhe prej 6 (gjashtë) muaj kalendarikë dhe;

b) i licencuari nuk ka njoftuar ERE-n që ai ka ndërmend të përdorë, riparojë apo zëvendësojë këto pajisje dhe impiante.

2. I licencuari duhet të ndërmarrë menjëherë veprimet e nevojshme për zhvendosjen e pajisjeve të braktisura dhe të bëjë restaurimin e zonës në kushtet që ajo ka qenë para fillimit të ushtrimit të aktivitetit të licencuar dhe të riparojë çdo dëm të ambientit të shkaktuar si rezultat i veprimtarisë së të licencuarit.

3. Të gjitha shpenzimet për braktisjen e pajisjeve apo faciliteteve dhe rehabilitimin e zonës dhe ambientit i ngarkohen të licencuarit.

4. I licencuari do të mbajë ERE-n dhe shtetin shqiptar jashtë çdo kostoje zhdëmtimi dhe përgjegjësie tjetër, përfshirë rehabilitimin e dëmtimeve mjedisore të shkaktuara ose që kanë ardhur si pasojë e gabimeve të të licencuarit në ushtrimin e aktivitetit sipas kësaj licence.

PJESA E KATËRT

Neni 11

Pagesat rregullatore

I licencuari duhet të paguajë në ERE pagesat në mënyrë të rregullt gjatë gjithë kohës së mbajtjes së licencës në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, legjislacionin në fuqi dhe “Rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017. Në qoftë se i licencuari nuk kryhen këto pagesa në masën dhe kohën e caktuar, atëherë ndaj tij merret masë administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 12

Tarifat

1. Tarifat e përcaktuara nga ERE marrin parasysh nevojën e integritetit të sistemit, reflektojnë kostot reale, me qëllim kthimin e duhur të investimeve të të licencuarit.

2. Tarifa e shpërndarjes rregullohet dhe aprovohet nga ERE bazuar në “Metodologjinë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.

3. Tarifa e shpërndarjes e aprovuar nga ERE do të vendoset për të siguruar të licencuarin me:

a) të ardhurat e mjaftueshme për mbulimin e niveleve të arsyeshme të kostove, përfshirë koston e kapitalit;

b) sigurimin e një norme të arsyeshme fitimi dhe

c) nxitje (incentiva) për reduktimin e kostove dhe operimin në mënyrë më eficiente;

d) stimuj të mjaftueshëm në planin afatgjatë dhe afatshkurtër për të rritur eficiencën, për të nxitur integrimin e tregut dhe sigurinë e furnizimit, si dhe për të ofruar mbështetje për veprimtaritë kërkimore.

4. Për sasinë e gazit natyror të shpërndarë nga i licencuari, si edhe për shërbimet e ofruara prej tij, i licencuari autorizohet të vendosë pagesa për të gjithë përdoruesit e sistemit të shpërndarjes, me kusht që këto pagesa të jenë sipas tarifave të shpërndarjes të aprovuara nga ERE. Vlera e këtyre pagesave përcaktohet mbi bazën e tarifës së shpërndarjes dhe sasinë e gazit të regjistruar në matësit e instaluar në:

a) kufirin e sistemit të shpërndarjes dhe sistemit të transmetimit në të cilin është lidhur dhe

b) kufirin e sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve, të cilët marrin lidhje direkt me sistemin e shpërndarjes.

5. Bazuar në aplikimin e të licencuarit ose me iniciativën e tij, ERE mund të rishikojë tarifën e shpërndarjes dhe ta ndryshojë atë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe “Metodologjinë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, të miratuar nga ERE.

Neni 13

Matja dhe sistemi i raportimit

1. I licencuari do të regjistrojë të gjithë volumet e gazit natyror që hyjnë ose dalin nga sistemi i shpërndarjes në përputhje me Kodin e Sistemit të Shpërndarjes. Në vendet ku nuk ka matës ose kur matësit nuk regjistrojnë në mënyrë korrekte, i licencuari do të përcaktojë sasinë e gazit të shpërndarë në përputhje me Kodin e Sistemit të Matjes, miratuar nga ERE sipas nenit 104 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe do të ndërmarrë pa vonësë masa për instalimin ose riparimin e pajisjeve të nevojshme matëse.

2. I licencuari mban raporte të detajuara mujore për sasinë e gazit që hyjnë ose gjenden në sistemin e shpërndarjes, operimin e sistemit të shpërndarjes dhe detaje të tjera të sistemit të shpërndarjes.

3. I licencuari u dorëzon mbi baza mujore të gjithë përdoruesve të sistemit të shpërndarjes, me të cilët ka lidhur kontrata për sigurimin e shërbimeve të shpërndarjes, të dhëna lidhur me sasinë e gazit të shpërndarë, në përputhje me kontratën e lidhur me çdo përdorues.

PJESA E PESTË

Neni 14

Monitorimi i performancës së aktivitetit të licencuar

1. ERE monitoron të licencuarin lidhur me zbatimin e kushteve të licencës, shqyrton raportet e të licencuarit dhe, kur e shikon të arsyeshme, ERE inspekton asetet, llogaritë apo të dhëna të tjera dhe kërkon auditimin e aktiviteteve të të licencuarit. Kostot e auditimeve janë për llogari të të licencuarit. Për këtë qëllim, ERE duhet të ketë akses të pakufizuar te llogaritë e të licencuarve sipas nenit 31 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Në vijim të një ankese të argumentuar të një pale të tretë, apo me iniciativën e vetë, ERE mund të fillojë një hetim administrativ të pajtueshmërisë së aktivitetit të të licencuarit me kushtet e licencës dhe legjislacionin në fuqi.

2. Veprimtaritë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes monitorohen nga ERE në mënyrë që operatori (OSSH) të mos përfitojë nga integrimi i tij vertikal dhe të shtrembërojë konkurrencën.

3. I licencuari duhet të sigurojë akses të plotë përfaqësuesve të autorizuar të ERE-s në dokumentacionin dhe raportet e të licencuarit për të kontrolluar aktivitetin e licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. I licencuari duhet të japë të gjithë ndihmën e nevojshme gjatë procesit të kontrollit.

4. Në qoftë se pas investigimit, ERE arrin në përfundimin që i licencuari nuk ka përmbushur kushtet e licencës, ERE mund të rishikojë tarifën e të licencuarit dhe/ose merr masat e nevojshme në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, legjislacionin në fuqi, me qëllim mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të gazit natyror.

5. I licencuari duhet të informojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës brenda 7 (shtatë) ditëve kalenderike nga dita e marrjes dijeni të një fakti të tillë.

6. I licencuari duhet të zbatojë të gjitha vendimet e marra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vendosura nga ERE, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Cilësia e shërbimit

1. I licencuari është i detyruar të:

a) Sigurojë shërbim cilësor të shpërndarjes së gazit natyror që lidhet me:

(i) vazhdueshmërinë e livrimit;

(ii) cilësinë e gazit natyror që hyn në sistemin e shpërndarjes dhe ruajtjen e cilësisë së tij deri në daljen nga sistemi, si dhe

(iii) cilësinë tregtare të shërbimit.

b) Të hartojë një metodologji për standardet dhe monitorimin e cilësisë së gazit natyror në pikat e hyrjes dhe të daljes së sistemit të shpërndarjes si pjesë e Kodit të Rrjetit të Transmetimit që do të miratohet nga ERE dhe

c) të monitorojë në vijimësi cilësinë e gazit të shpërndarë dhe të dorëzojë pranë ERE-s raporte periodike, në përputhje me metodologjinë e aprovuar.

2. I licencuari duhet të sigurojë dhe të përmbushë cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes, siç përcaktohet nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe kërkesat minimale në lidhje me cilësinë e shpërndarjes të vendosura nga ERE, dhe duhet të sigurojë shërbimet sipas specifikimeve të cilësisë dhe kushteve të vendosura te Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes.

Neni 16

Konfidencialiteti i informacionit

1. I licencuari duhet të sigurojë që çdo informacion i marrë si rezultat i ushtrimit të aktivitetit të licencuar nuk do t'i bëhet i ditur askujt me përjashtim të rasteve kur:

a) Informacioni duhet të bëhet me dije gjatë kryerjes së aktivitetit të licencuar në përputhje me kërkesat e transparencës të përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror" dhe pa ndikuar te detyrimi i të licencuarit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar.

b) Të licencuarit i kërkohet të deklarojë informacionin në përputhje me kushtet e licencës.

c) Është vendosur nga ERE.

d) Jepet pëlqimi paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni.

e) Me vendim të gjykatës dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

f) Në qoftë se informacioni është bërë publik.

2. I licencuari do të sigurojë që çdo biznes shoqërues nuk do të përdorë asnjë informacion të të licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion tek ndonjë person tjetër (përfshirë biznese të tjera të lidhura), që mund ta mundësojnë këtë person të arrijë përfitim tregtar të pajustificuar.

3. Çdo informacion me avantazh tregtar në pronësi të të licencuarit duhet të shpërndahet në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, dhe duhet të aksesohet lehtësisht dhe në mënyrë të barabartë nga të gjithë përdoruesit aktualë dhe të mundshëm të sistemit dhe palët e tjera të interesuara. Shpërndarja e informacionit me avantazh tregtar duhet të përpunohet për të parandaluar trajtimet preferenciale të përdoruesve individualë të sistemit ose palëve të tjera të interesuara, në lidhje me fushëveprimin, përmbajtjen dhe/ose formën e informacionit të shpërndarë, dhe/ose kohën kur ai është shpërndarë.

4. I licencuari do të hartojë dhe do të paraqesë pranë ERE-s procedurat për të siguruar zbatimin e kësaj pike Politika e konfidencialitetit e të licencuarit mund të përshkruhet te programi i pajtueshmërisë, duke iu referuar kushteve të kësaj licence dhe/ose akteve të tjera nënligjore. Politika e konfidencialitetit të të licencuarit duhet të publikohet në faqen e të licencuarit dhe duhet të jetë e aksesueshme nga çdo palë e interesuar.

5. I licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta ruajtur informacionin konfidencial në posedim të të licencuarit dhe për t'i raportuar ERE-s në përputhje me obligimet e paraqitura në këtë nen.

6. Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik, me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE-ja me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe nuk duhet të bëhet përhapja e tij në publik.

7. ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të siguruar nga i licencuari sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

PJESA E GJASHTË

Neni 17

Amendimet e licencës

Amendimi i kushteve të kësaj licence do të bëhet në përputhje me "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror" dhe nenit 28 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

Neni 18

Vendosja e masave administrative dhe heqja e licencës

1. Nëse i licencuari nuk përmbush kushtet e kësaj licence, ERE mund të aplikojë masa administrative,

sipas nenit 106 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje”.

2. ERE mund të heqë licencën në përputhje me nenin 27, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

3. Në qoftë se i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose strukturën e kontrollit të interesave të aksionarëve pa autorizimin e ERE-s, bordi i ERE-s vendos shfuqizimin e vendimit të licencimit dhe licenca bëhet e pavlefshme. Subjekti pasues i të licencuarit duhet të aplikojë për një licencë të re në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta e apelit

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet të licencuarit dhe çdo përdoruesi të sistemit të shpërndarjes apo ndonjë personi tjetër që lidhet me aktivitetin e shpërndarjes ose kushtet e kësaj licence do të zgjidhet me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Në rast se nuk arrihet në zgjidhje të mosmarrëveshjes me mirëkuptim, atëherë, bazuar në kërkesën e çdo pale që është pjesë e kësaj mosmarrëveshjeje, ERE nxjerr vendimin e saj në zbatim të nenit 98, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

3. I licencuari mund të apelojë vendimin e ERE-s në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e vendimit.

4. I licencuari ka detyrimin të zbatojë vendimin e ERE-s deri në nxjerrjen e një vendimi nga gjykata kompetente mbi kërkesën, shqyrtimin e vendimit të ERE-s.